


LICENCIMI NË SEKTORIN E ENERGJISË

SFIDAT, BARRIERAT DHE REKOMANDIMET



Titulli: LICENCIMI NË SEKTORIN E ENERGJISË
Sfidat, barrierat dhe rekomandimet

Autori: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Publikuar: Maj, 2024

Projekti “Mbështetje për Shoqërinë Civile për të Ritur Mbikëqyrjen Publike dhe Llogaridhënien e Institucioneve Publike të Kosovës” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti GAP (GAP) dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), dhe nuk pasqyron domosdoshmerisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.

LICENCIMI NË SEKTORIN E ENERGJISË

SFIDAT, BARRIERAT DHE REKOMANDIMET

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA	6
LICENCIMI NË SEKTORIN E ENERGJISË	7
Çka nënkuptojmë me licencë?	8
Procedurat e aplikimit për licencë	9
SFIDAT DHE BARRIERAT PËR LICENCIM	13
PËRFUNDIME	17
REKOMANDIME	18

HYRJE

Licencimi në sektorin e energjisë në Kosovë është një proces kyç për zhvillimin e burimeve të qëndrueshme të energjisë dhe përmbushjen e objektivave ndërkombëtare të vendosura nga Bashkimi Evropian. Kosova ka detyrime për të arritur targetet për energji të ripërtërishme dhe për të reduktuar emetimet e gazrave serrë në përputhje me marrëveshjet dhe standardet evropiane. Këto targete kërkojnë investime të mëdha në teknologji të gjelbra, duke përfshirë instalimin e sistemeve fotovoltaike, turbinave të erës dhe impianteve të tjera të burimeve të ripërtërishme të energjisë. Për të realizuar këto objektiva, është thelbësore një strukturë efikase dhe transparente e licencimit që lehtëson investimet dhe garanton zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë në sektorin e energjisë.

Procesi i licencimit në Kosovë për sektorin e energjisë përfshin disa hapa dhe rregulla strikte që duhet ndjekur nga investitorët dhe operatorët e rinj. Kompleksiteti i procedurave dhe koha e gjatë që kërkohet për të marrë autorizimet dhe lejet e nevojshme, janë duke rezultuar në humbjen e interesit të investitorëve potencial. Përveç kësaj, infrastruktura e kufizuar dhe kapacitetet e pamjaftueshme administrative të institucioneve përgjegjëse, së bashku me mungesën e koordinimit ndërmjet akterëve përgjegjës, vetëm sa janë duke e ndërlikuar licencimin më tutje. Një licencim i drejtë dhe i thjeshtë është thelbësor për tërheqjen e investitorëve dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit energjetik. Përmirësimi i procesit të licencimit do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi më të favorshëm për investime dhe zhvillim të përgjithshëm të infrastrukturës energjetike.

Ky raport tematik mbi licencimin në sektorin e energjisë në Kosovë ofron një analizë të detajuar të gjendjes aktuale dhe rekomandime specifike për përmirësimin e procedurave në tërësi. Gjetjet kryesore të raportit përfshijnë nevojën për thjeshtimin dhe përshtetimin e procedurave të licencimit, digjitalizimit, si dhe përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe teknike të institucioneve përgjegjëse. Raporti rekomandon gjithashtu forcimin e kornizës ligjore dhe rregullative për të siguruar një mjedis më të favorshëm për investimet në energjinë e ripërtërishme. Zbatimi i këtyre rekomandimeve është çelësi për të përmbushur objektivat energjetike të Kosovës dhe për të garantuar një të ardhme të qëndrueshme dhe të pavarur energjetike për të gjithë konsumatorët duke kontribuar njëkohësisht në rritjen e transparencës dhe llogaridhënien nga palët e përfshira pavarësisht nivelit të tyre operues.

METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij raporti janë përdorur metoda kuantitative dhe kualitative për të siguruar një analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse të procesit të licencimit në sektorin e energjisë në Kosovë. Fillimisht, janë analizuar dokumente zyrtare legjislative që përfshijnë rregulloret dhe ligjet e institucioneve kryesore të përfshira në vendimmarrjen për marrjen e licencës në sektorin e energjisë. Ky hap ka përfshirë shqyrtimin e ligjeve në fuqi, rregulloreve të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), dokumenteve të OST-së (KOSTT) dhe OSSH-së (KEDS), si dhe planeve dhe strategjive nacionale për energjinë. Përveç analizës së këtyre dokumenteve, është kryer edhe një vlerësim i detajuar i procedurave ekzistuese për të identifikuar pengesat dhe sfidat kryesore me të cilat përballen aplikantët në këtë sektor.

Përpos analizave të përmendura më lart, të dhënat janë mbledhur dhe përpunuar edhe nga debatet dhe forumet e ndryshme avokuese, jo vetëm gjatë implementimit të projektit CorrWatch, por gjithashtu edhe nga intervistat me përfaqësues të kompanive dhe bizneseve në sektorin e energjisë. Kjo metodologji gjithëpërfshirëse synon të sigurojë që gjetjet dhe rekomandimet e raportit të jenë të dobishme për të gjithë akterët në sektorin e energjisë, duke përfshirë institucionet vendimmarrëse, investitorët dhe komunitetin e biznesit. INDEP ka takuar dhe intervistuar akterë institucional të nivelit qendror dhe komunal, përfaqësues të bizneseve, investitorë potencial, si dhe konsulentë dhe inxhinierë të energjisë. Këto intervista na mundësuan të mbledhim njohuri, të mësojmë detaje që legjislacioni shpesh nuk i parasheh dhe të fitojmë ekspertizë në këtë fushë. Për më tepër, për të marrë informata të dorës së parë, monitoruesit tanë morën pjesë aktive në procedurat për dhënien e lejeve dhe licencave, duke rritur kështu saktësinë dhe besueshmërinë e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit.

**LICENCIMI
NË
SEKTORIN
E
ENERGJISË**



ÇKA NËNKUPTOJMË ME LICENCË?

Licencimi në sektorin e energjisë është një proces i rregulluar që përcakton kushtet dhe kriteret për operimin e kompanive dhe individëve që dëshirojnë të prodhojnë, transmetojnë, shpërndajnë ose furnizojnë energji elektrike. Ky proces sigurohet nga autoritetet rregullatore si Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në Kosovë, e cila mbikëqyr dhe administron licencat për të gjitha entitetet që operojnë në këtë sektor. Licencimi përfshin një sërë dokumentesh dhe procedurash që duhet të plotësohen për të siguruar që aktivitetet energjetike të zhvillohen në përputhje me standardet ligjore dhe rregulloret teknike. Kjo përfshin gjithashtu vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe përputhshmërinë me politikat kombëtare të energjisë. Dokumentet dhe legjislacioni që rregullojnë licencimin në sektorin e energjisë përfshijnë ligje dhe rregullore të miratuara nga autoritetet kombëtare dhe entet rregullatore si ZRRE. Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për Energjinë e Ripëtërishme dhe rregulloret e tjera përkatëse përshkruajnë në detaje procedurat dhe kriteret për marrjen e licencave. Përveç kësaj, rregullatorët ndërkombëtarë dhe direktivat e Bashkimit Evropian gjithashtu ndikojnë në politikat dhe praktikët licencuese në Kosovë. Këto dokumente sigurojnë që procesi i licencimit të jetë transparent, i drejtë dhe në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, duke mbështetur zhvillimin e një sektori energjetik të qëndrueshëm dhe efikas.

Licencimi është i rëndësishëm sepse siguron një kornizë të qartë dhe të qëndrueshme për operimin e sektorit të energjisë, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve dhe duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me energji. Një proces i mirëorganizuar i licencimit ndihmon në krijimin e një tregu të drejtë dhe konkurrues, ku kompanitë e energjisë mund të operojnë në kushte të barabarta. Për më tepër, licencimi garanton që të gjitha aktivitetet në sektorin e energjisë janë të monitoruara dhe të kontrolluara për të parandaluar praktikët abuzive dhe për të siguruar që ofruesit e energjisë përmbushin detyrimet e tyre ndaj konsumatorëve dhe mjedisit. Ky kontroll është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit dhe për përmbushjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare për energji të pastër.

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR LICENCË

Procedurat për aplikim për licencë në sektorin e energjisë variojnë në bazë të fuqisë së kapacitetit të instaluar si dhe në bazë të llojit të aplikantit, i cili mund të jetë konsumator shtëpiak apo biznes. Për konsumatorët vetanakë (shtëpiak), procesi në tërësi merr kohë më pak dhe konsiderohet më i thjeshtë, ndërkaq për bizneset, veçanërisht ato me kapacitet më të madh se 10 MW të instaluar, procedurat konsiderohen më të ndërlikuara. Ky ndryshim në dokumentacion përfshin plane teknike, studime të ndikimit në mjedis (përfshirë Raportin e VNM-së), leje ndërtimore si dhe leje mjedisore. Për të siguruar pajtueshmëri me rregulloret dhe standardet, është e domosdoshme që të gjitha dokumentet të jenë të plota dhe të sakta. Në vijim, në pika të shkurtuara janë përshkruar hapat për aplikim për licencë duke përfshirë edhe institucionet përgjegjëse.

PROCEDURAT E LICENCIMIT PËR SISTEME PV DERI NË 7kW

KËRKESA PËR
RRITJE TË FUQISË -
OSSH



Ky formular përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për të vlerësuar fuqinë e kërkuar për sistemin diellor që aplikuesi dëshiron të kyç në rrjet si dhe rritjen e fuqisë aktuale të njehsorit të cilin e posedon.

KËRKESA PËR PËLQIM
ELEKTROENERGJETIK -
OSSH



Kjo kërkesë përfshin aplikimin për miratimin e përdorimit të energjisë elektrike që do të gjenerohet nga sistemi solar fotovoltaik dhe kapacitetin e lejuar për instalim.

KËRKESA PËR
APROVIM PROJEKTI
DHE LEJE HYRJE-
OSSH



Klienti dorëzon projektin e planifikuar për instalimin e sistemit dhe në rast që dokumentacioni është në e rregull, mirret Pëlqimi në fjalë dhe leja për kyçje në rrjet.

APLIKIMI PËR
VETGJENERATOR -
ZRRE



Është procedura për aplikimin zyrtar për t'u klasifikuar si vetgjenerator, duke u kualifikuar për përfitimet dhe kthimin e energjisë së tepërt në rrjet. Aplikimi për këtë procedurë realizohet nëpërmjet faqes zyrtare të ZRRE-së.

KËRKESA PËR
PRANIM TEKNIK -
OSSH



Kjo kërkesë përfshin inspektimin dhe miratimin teknik të sistemit solar nga ana e autoritetit përgjegjës, pra, OSSH-së.

KËRKESA PËR
NDËRRIM TË
NJEHËSORIT - OSSH



Rishikohet nëse është e nevojshme të bëhen ndryshime në dokumentacionin zyrtar për njehsorin e klientit. Nëse gjithçka është në rregull, ekipi nga OSSH kryen ndërrimin e njehtësorit nga njehtësori konvencional në atë dykahor.

MARRËVESHJA PËR
PROSUMATOR -
OSSH



Ky dokument formalizon marrëveshjen mes klientit dhe furnizuesit të energjisë në lidhje me shkëmbimin e energjisë elektrike midis dy palëve.

KONTRATA PËR
PROSUMATOR -
OSSH



Finalizohet kontrata, e cila përfshin të gjitha detajet dhe kushtet e bashkëpunimit mes klientit dhe furnizuesit të energjisë.

PROCEDURAT E LICENCIMIT PER SISTEME PV MBI 7kW

Kur fuqia e sistemit fotovoltaik kalon kapacitetin prej 7kW, procedurat për licencim shquhen të jenë pak më të ndëlikuara. Përpos dokumenteve të lartpërmendura, nevojiten edhe dy tjera shtesë. Këto, mund të sigurohen në komunën përkatëse.

LEJA NDËRTIMORE-
KOMUNË



Leja ndërtimore nga komuna është dokumenti zyrtar i cili lejon ndërtimin e një strukture në territorin e një komune, duke u pajisur me lejen dhe lejet e nevojshme përkatëse për zbatimin e projektit.

PËLQIMI MJEDISOR-
MMPHI



Ky dokument siguron që ndërtimi dhe operimi i Sistemit PV të jetë në harmonizim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit.

PËLQIMI PARIMOR/
OST



Ky dokument nevojitet në rast që objekti ndodhet në afërsi të linjave të tensionit të lartë. Dokumenti i kërkuar i cili ka kosto shtesë, mirret në OST.

Për kapacitetet e reja gjeneruese deri në **5 MW**, licencimi realizohet me ndërmjetësimin e **OSSH-së**. Ndërkaq, për kapacitetet e reja gjeneruese **nën ose të barabarta me 10 MW**, licencimi mund të realizohet edhe nëpërmjet **OST-së**. Në këtë rast, kur kapaciteti i fuqisë së instaluar është më i lartë, nevojiten dokumente shtesë si:

Fleta poseduese e lokacionit të projektit



Certifikata e biznesit e kompanisë të kontraktuar për ndërtim



Studimi i fizibilitetit, i detajuar



Leja Mjedisore apo Leja Ujore si dhe Leja e Ndërtimit



Pasi të jenë marrë dokumentet dhe lejet e nevojshme, investitori duhet të aplikoj për Autorizim në ZRRE duke përfshirë pagesën e taksave të aplikueshme. Aplikacioni me të gjitha dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohet në formë të shkruar në një kopje origjinale dhe një kopje në formë elektronike. Përpos kësaj, investitori, është gjithashtu përgjegjës për njoftimin e projektit në dy (2) gazeta elektronike ditore. Nëse ZRRE konstaton se aplikanti i ka plotësuar të gjitha kërkesat, do të nxjerrë një Vendim për Autorizim për një kohëzgjatje prej njëzet e katër (24) muaj, duke konfirmuar të drejtën e investitorit për të filluar me ndërtimin. Afati mund të zgjatet edhe për një (1) muaj shtesë, nëse arsyetohet nga Investitori.

Me nxjerrjen e vendimit për autorizim, ZRRE-ja kërkon që brenda 30 ditëve investitori (aplikanti) i BRE-ve të dorëzojë një garanci financiare, të lëshuar nga një bankë komerciale apo kompani sigurimi, e cila do të mbulojë periudhën nga lëshimi i autorizimit deri në finalizimin e ndërtimit të projektit të energjisë. Dokumentet e nevojshme, për sigurimin e Autorizimit nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë janë:



Formulari I aplikacionit (emri, adresa, statusi i aplikantit dhe emri i projektit)




Dëshmia e pagesës për shërbimin e Pëlqimit Mjedisor




Certifikata e Regjistrimit të Biznesit



Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme



Kopja e planit dhe koordinatat në Sistemin Ref të Kosovës



Plani i rilevimit të tokës nga gjeodeti i licencuar



Investitorët e BRE-ve që vendosin të ndërtojnë kapacitet të reja gjeneruese mbi 5 MW, ju kërkohet të aplikojnë për Licencë Gjenerimi, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

PËR KAPACITETET E REJA GJENERUESE TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME KAPACITET INSTALUES NËN 5 MW, NUK KËRKOHEM LICENCË PRODHIMI



Aktualisht, investitorët e BRE-ve në Kosovë mund të shesin prodhimin e tyre të energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të sipas një Kornize të Rregulluar ose në kushte të tregut. Korniza e Rregulluar ofron një çmim referencë të miratuar nga Rregullatori dhe garanton një MBE me Operatorin e Tregut. Investitorët mund të zgjedhin të shesin prodhimin e tyre me çmime të parregulluara bazuar në kushtet e tregut të hapur, i cili nuk garanton një marrëveshje për blerjen e energjisë me operatorin e tregut.

Sipas Kornizës së Rregulluar, siç specifikohet në Rregullën për Skemat Mbështetëse, Marrëveshja për Blerjen e Energjisë për investitorët do të ketë një kohëzgjatje minimale prej 1 (një) viti dhe mund të zgjasë deri në periudhën e vlefshmërisë së licencës së gjenerimit të investitorit të lëshuar nga ZRRE. Megjithatë, nëse investitorit nuk i kërkohet të marrë një Licencë Gjenerimi, kohëzgjatja e Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë do të kufizohet në një maksimum prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh. Afati i përfundimit i të gjitha proceseve, mund të zgjasë deri në gjashtë (6) vite kalendarike.



SFIDAT

DHE

BARRIERAT

PËR

LICENCIM

Sektori i energjisë në Kosovë përballë me një sërë sfidash dhe barrierash që ndikojnë në zhvillimin dhe funksionimin e tij. Këto probleme përfshijnë aspekte të ndryshme, të cilat kërkojnë vëmendje dhe zgjidhje për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm me energji. Instalimi i një sistemi solar fotovoltaik mund të përballë sfida të ndryshme, duke filluar nga konteksti lokal, rrethanat mjedisore, ligjshmëria dhe kushtet ekonomike. Disa sfida të mundshme që një klient mund të hasë gjatë këtij procesi janë ilustruar me poshtë, duke filluar nga:




KOSTO E LARTË E INVESTIMIT

Një nga sfidat kryesore për shumë klientë është investimi fillestar i lartë që kërkon instalimi i një sistemi solar. Edhe pse kostoja e instalimit ka rënë vitet e fundit, ende mbetet një shumë e konsiderueshme paraprake që klientët duhet të përballojnë. Vlen të përmendet se sistemet e vogla kanë një çmim për këp më të lartë se sistemet e mëdha, gjë që shpesh i largon investitorët individual.



PROCEDURAT E NDËRLIKUARA ADMINISTRATIVE

Procedurat administrative të ndërlikuara pengojnë zhvillimin e bizneseve me kohë dhe kostot e tyre, duke bërë që investitorët të heshtin përpara hapjes së biznesit. Thjeshtimi dhe automatizimi i këtyre proceseve mund të ulë barrën administrative dhe të inkurajojë rritjen ekonomike.



MUNGESA E LEJES NDËRTIMORE

Pasi që shumica e objekteve të vjetra në Kosovë janë ndërtuar pa leje, kjo e bën të pamundur vendosjen e një sistemi fotovoltaik me kapacitet mbi 7 kW. Gjithashtu, në raste kur objekti është ndërtuar me leje, por është në afërsi të linjave të tensionit, aplikimi për Pëlqim Elektroenergjetik konsiderohet të jetë i pamundur.



ÇMIMET E LARTA TË TRANSPORTIT TË PAJISJEVE

Çmimet e larta të transportit të pajisjeve solare rrisin ndjeshëm koston totale të instalimit të sistemit solar për klientët. Këto kosto shtesë ndikojnë negativisht në përballueshmërinë dhe atraktivitetin e investimeve në energji të gjelbërt.




VENDNDODHJA DHE HAPËSIRA E DISPONUESHME

Instalimi i një sistemi diellor fotovoltaik (PV) mund të jetë problematik për shkak të ekspozimit të pamjaftueshëm të dritës së diellit, orientimit jo të duhur të çatisë, hapësirës së kufizuar, kushteve të pafavorshme të motit, kufizimeve rregullatore, çështjeve të lidhjes në rrjet dhe rezistencës së komunitetit. Këta faktorë ndikojnë në efikasitetin, fizibilitetin dhe efektivitetin e përgjithshëm të sistemit në prodhimin e energjisë elektrike.




INVESTIMET DHE RREZIKU FINANCIAR

Projekte të mëdha fotovoltaike kërkojnë investime të konsiderueshme fillestare. Kompanitë projektuese duhet të kenë qasje në burime financiare të mjaftueshme dhe të jenë të afta të menaxhojnë rreziqet financiare të lidhura me projekte të tilla. Projektet e mëdha energjinë e tregtojnë në rrjetin energjetik dhe kompania duhet të marrë perbazë rrezikun për çmimin e ultë të tregtimit i cili mund ti ofrohet klientit nga ZRRE.



MUNGESA E NJË ONE STOP SHOP

Mungesa e një one stop shop për të gjitha nevojat e tyre mund të shkaktojë disa vështirësi. Pa qasje të lehtë në informacion dhe këshillim të specializuar, ata mund të hasin në probleme gjatë procesit të zgjedhjes dhe instalimit të sistemeve. Kjo mund të çojë në vendime të gabuara dhe në zgjedhjen e një sistemi që nuk është më i përshtatshmi për nevojat e tyre, duke sjellë humbje të kohës dhe të burimeve financiare.



DIGJITALIZIMI

Procedurat manuale dhe burokratike për licencimin kërkojnë udhëtime të shpeshta dhe dorëzimin e dokumenteve origjinale, rritur kështu kostot dhe kohën. Sistemet digjitale për aplikimin dhe dorëzimin e dokumenteve mund të thjeshtojnë këto procedura, eliminuar nevojën për prezencë fizike dhe përmirësuar efikasitetin dhe transparencën, duke lehtësuar barrën administrative për kompanitë dhe duke inkurajuar investime në sektorin e energjisë.



FUQI PUNËTORE E KUFIZUAR

Projekte të mëdha fotovoltaike kërkojnë një menaxhim të kujdesshëm të projektit për të siguruar që puna të kryhet në kohë dhe brenda buxhetit. Kompanitë projektuese duhet të kenë ekipet dhe resurset e duhura për të menaxhuar efikasitetin e projekteve të tyre dhe si pasojë e situatës aktuale në Kosovë dhe sistemit arsimor, fuqia punëtore dhe rekrutimi i personave adekuat e të trajnuar po bëhet thuajse i pamundur.



MUNGESA E BURIMEVE NJERËZORE

Kjo mund të çojë në vonesa në proceset administrative dhe në vështirësi për të përmbushur detyrat e nevojshme për një funksionim efikas. Në sektorin e energjisë, kjo mund të shkaktojë edhe vonesa në zbatimin e projekteve të energjisë së ripërtërishme dhe në koordinimin e rëndësishëm me ndërmarrjet private.



MUNGESA E BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL

Mungesa e bashkëpunimit ndërinstitucional mund të komplikojë më tej procesin e instalimit të sistemeve solare fotovoltaike. Pa një koordinim efektiv ndërmjet institucioneve të ndryshme, procedurat burokratike mund të bëhen më të ndërlikuara dhe të vonuara, duke krijuar pengesa të panevojshme për klientët dhe investitorët.



LEGJISLACION JO I HARMONIZUAR

Ndryshimet në ligjet dhe politikat qeveritare lidhur me energjinë solare mund të shkaktojnë vështirësi për OSSH-në në interpretimin dhe zbatimin e rregullave të reja. Kjo mund të krijojë paqartësi dhe vonesa në procesin e lidhjes së sistemeve solare me rrjetin, duke ndikuar negativisht në investimet dhe zhvillimin e energjisë së ripërtërishme.


PËRFUNDIME

Sektori i energjisë elektrike në Kosovë është i pasigurtë. Mungesa e burimeve gjeneruese rezervë dhe varësia nga impiantet ekzistuese në Obiliq vetëm sa po e shton lëkundjen e sigurisë së sektorit, si dhe furnizimit të vazhdueshëm me energji elektrike. Ndonëse gjatë dekadës së fundit ka pasur përmirësime të dukshme në infrastrukturën energjetike dhe incentivave në këtë sektor, ulja e emitimeve të karbonit nuk ka të rënë. Për më tepër, faktorë të ndryshëm si inflacioni, shkalla e dobët e arkëtimit për shkak të përdorimit të paligjshëm të energjisë elektrike, mungesa e planifikimit, mosharmonizimi dhe mungesa e vendimmarrjeve të duhura ndërinstitucionale, së bashku me krizën energjetike në nivel botëror, po e çojnë Kosovën drejt një humnere e cila rrezikon të mbetet pa furnizim stabil me energji elektrike për një kohë të pacaktuar.


Për të përmbushur objektivat e vendosura, është urgjente të rimodelohen skemat mbështetëse, të rishikohen procedurat licencuese për burime të ripërtërishme të energjisë, si dhe të investohet në programe konkrete të efijencës së energjisë. Tranzicioni nga lëndët fosile në burimet e ripërtërishme kërkon një përpjekje të koordinuar dhe mbështetje të qëndrueshme nga qeveria, institucionet përkatëse dhe vetë konsumatorët final. Procedurat e licencimit, të cilat janë shpesh të ndërlikuara, shkaktojnë vështirësi të konsiderueshme për investitorët dhe operatorët. Në këtë kontekst, digjitalizimi i procesit të licencimit është jetësor për rritjen e transparencës dhe lehtësimin e barrës administrative. Një implementim i suksesshëm i kësaj do të sjellë përparim të shpejtë në mjedisin e biznesit dhe investimeve.

The challenges of the electricity sector in Kosovo require a comprehensive approach to be effectively addressed. The reduction in the price of investments, the rapid increase in investment return and the framing of support schemes in the energy market in Kosovo have attracted foreign investors, who are expressing great interest in investing in the country. However, to capitalize on this interest and ensure a sustainable energy future, it is essential that the government creates a favorable regulatory environment, improves the transparency and efficiency of licensing processes, and strengthens inter-institutional cooperation. These measures will help address existing challenges and ensure a stable and secure electricity supply for the future.


REKOMANDIME




Të thellohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve kyçe për marrjen e lejeve si ZRRE, MMPHI dhe ME dhe zyrtarëve të nivelit komunal. Përfshirja aktive e përfaqësuesve të zyrtarëve në nivel komunal dhe informimi i tyre në kohë lidhur me ndryshimet e pësuar në kornizën ligjore sa i përket sigurimit të lejeve dhe licencave përkatëse, paraqet një element thelbësor për zhvillimin e sektorit të energjisë. Kjo gjithëpërfshirje, do të kontribuonte në një proces më transparent dhe më të përgjegjshëm në planifikimin dhe zbatimin e politikave dhe masave në sektorin e energjisë.




Të themelohet një ONE STOP SHOP. Një one stop shop do të lehtësonte këtë proces duke ofruar një burim të vetëm për informacion, këshilla dhe shërbime të plota, duke ndihmuar klientët të bëjnë zgjedhjet e duhura për nevojat e tyre specifike. Gjithashtu, investitorët do të kursenin kohë dhe resurse duke shmangur nevojën për të shkuar në shumë institucione për të përmbushur kërkesat për licencim. Kjo gjithashtu do të kontribuonte në uljen e barrës administrative për bizneset dhe institucionet, duke lehtësuar procesin dhe duke rritur transparencën në të gjithë procesin e licencimit.




Të hartohet një politikë tatimore e favorshme për produktet që kanë për qëllim promovimin e energjisë së ripërtërishme dhe për të inkurajuar investimet në sektorin e energjisë. Përmes prezantimit të reformave tatimore të përshtatshme, qeveria mund të nxisë lulëzimin e tregut të ndërmarrjeve të cilat promovojnë energjinë e gjelbërt duke kontribuar në nxitjen e konkurrencës së shëndetshme në tregun vendor. Rrjedhimisht, përpos fuqizimit të sektorit të energjisë, kjo do të ndikonte në krijimin e vendeve të reja të punës duke nxitur zhvillimin ekonomik njëkohësisht.




Të digjitalizohet procedura e aplikimit për licencë nga OSSH-ja. Një platformë digjitale për aplikimin për licencë do të ndihmonte në shmangien e vajtjes së individëve në komunat përkatëse, duke e bërë më të lehtë dhe më të shpejtë procesin e dorëzimit të dokumentacionit. Poashtu, digjitalizimi do të minimizonte mundësitë për keqpërdorime dhe korrupsion në këtë sektor, duke rritur në të njëjtën kohë nivelin e transparencës dhe barazisë gjatë licencimit në tërësi.



Të draftohen programe të veçanta si dhe të organizohen trajnime të ndryshme nga institucionet qeveritare me qëllim të rritjes së fuqisë punëtore në sektorin e energjisë. Në një të ardhme të afërt, aftësitë e tyre do të kontribuonin në përshtetimin e tranzicionit energjetik duke krijuar njëkohësisht mundësi për rritje të punësimit dhe inovacionit në sektorin e energjisë.



Të zhvillohen politika dhe programe mbështetëse për qytetarët të cilët kanë interes për të investuar në sektorin e energjisë së pastër. Subvencionimi i vazhdueshëm, ofrimi i granteve, kreditë pa interes, heqja e tatimeve, si dhe ofrimi i asistencës jo vetëm nga një "One Stop Shop", do të rriste pjesëmarrjen e qytetarëve në energjinë e pastër në gjenerimin total të vendit. Në këtë mënyrë, Kosova do të kalonte me hapa të përshpejtuar dhe të sigurt drejt arritjes së caqeve të vendosura për vitin 2031 dhe 2050 .



Të emërohet një përfaqësues përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e impaktit mjedisor të projekteve të ndryshme, të cilat aplikojnë për Leje Komunale me qëllim të licencimit, në Departamentin e Urbanizimit në çdo komunë. Në këtë mënyrë, monitorimi dhe vlerësimi i impaktit mjedisor të projekteve të ndryshme në nivel lokal, përmes një përfaqësuesi të emëruar në çdo komunë për këtë qëllim, do të rritë transparencën në procesin e licencimit, duke siguruar një regjistrim të përpiktë të të dhënave dhe duke përditësuar informacionin për projekte të caktuara. Kjo gjithashtu do të zvogëlojë mundësinë për keqpërdorime dhe mosmarrëveshje të mundshme, duke garantuar një përcaktim më të saktë dhe të ndershëm të impaktit mjedisorë të planeve urbane.

RAPORT TEMATIK

Licencimi në sektorin e energjisë
Sfidat, barrierat dhe rekomandime

05/2024



British Embassy
Pristina



Group for Legal
and Political
Studies

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

